



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 28 Shkurt 2023

Nr: 76

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË BASHKISË RROGOZHINË,
PËR RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 28 Shkurt 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Qendra "Qëndresa Qytetare"

SUBJEKT: Z. Elton Sula, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Rrogozhinë

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Rrogozhinë, për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, është njohur me denoncimin e Qendrës "Qëndresa Qytetare" datë 9.2.2023, administruar nëpërmjet shkresës nr. 780 prot. datë 13.02.2023, mbi organizmin e 1 (një) veprimtari publike të kryer nga bashkia Rrogozhinë, e cila pretendohet se rezulton e paraportuara në ndërfaqen e dedikuar për këtë qëllim.

Data: 28 Shkurt 2023

Nr: 76
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Rrogozhinë, për raportimin e veprimtarive publike"

Denoncimi është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

“...Më datë 2 shkurt 2023, mes mëngjesit dhe paradites, kryetari i bashkisë Rrogozhinë z. Edison Memollaj, i shoqëruar nga z. Etjen Xhafa, deputet i Partisë Socialiste të Shqipërisë, i zgjedhur në Qarkun e Durrësit, kanë organizuar një veprimtari publike në qytetin e Rrogozhinës, të hapur për mediat, me qëllimin e informimit të qytetarëve të Rrogozhinës mbi mbarëvajtjen e punimeve të rikonstruksionit në shkollën 9 vjeçare "George Soros". Më konkretisht, veprimtaria publike në formën e të parës nga afër të punimeve është kryer pikërisht në ambientet e kësaj shkolle.

Më datë 2 shkurt 2023, ora 18:49, z. Edison Memolla ka postuar fotografitë nga veprimtaria dhe mbikëqyrja e rikonstruksionit të shkollës 9-vjeçare me përshkrimin Inspektim për të parë nga afër ecurinë e punimeve në shkollën 9-vjeçare 'Xhorxh Sorros'. #BashkiaRrogozhinë **[Prova nr. 1- Postimi i Z. Edison Memolla në rrjetet sociale].**

Më datë 2 shkurt 2023, ora 19:42, z. Etjen Xhafaj ka postuar fotografitë nga kjo veprimtari me përshkrimin "Me Edisonin për të parë nga afër punimet në shkollën 9-vjeçare "George Soros", që pas rikonstruksionit do të jetë një hapësirë me e mirë dhe më e madhe dijeje për femijët e #Rrogozhinës #ShqipëriaEardhmjaJonë #SkaKohë Për Pushim Edison Memolla" **[Prova nr. 2 - Postimi i Z. Etjen Xhafaj në rrjetet sociale].**

Nga verifikimi në portalin e krijuar dhe administruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (aktivitete.kqz.gov.al), rezulton se aktiviteti i mësipërm, nuk është raportuar nga ana e personit përgjegjës për raportim **[Prova nr. 3 - Screenshot "Faqja e raportimeve të KQZ"]...**

Lidhur me këto prova Qendra "Qëndresa Qytetare" ndër të tjera pretendon se:

“...Në rastin konkret, siç vërtetohet dhe nga rrethanat e faktit, verifikohet ekzistenca e këtij kushti. Kjo pasi vizita e z. Memolla, në cilësinë e kryetarit të bashkisë, e shoqëruar me praninë e z. Xhafa, është pasqyruar dhe mbuluar në rrjetet e tyre sociale dhe për rrjedhojë, plotësohet kushti i një aktiviteti të hapur për median, në kuptimin e së cilës, nuk mund të përfshihet vetëm mbulimi radioteleviziv i ngjarjeve, por edhe shpërndarja e tyre përmjet mediave jo- tradicionale...

Duke mbajtur në konsideratë sa më sipër, si edhe faktin se vetë z. Memolla, bashkarisht me z. Xhafa, e kanë pranuar se qëllimi i këtij aktiviteti ka qenë vëzhgimi nga afër për të parë ecurinë e punimeve të rikonstruksionit të shkollës 9-vjeçare "George Soros", është e qartë se në rastin konkret, plotësohet tërësisht ky kusht i parë që lidhet me natyrën e aktivitetit...

Në rastin konkret, z. Memolla është kryetari i bashkisë Rrogozhinë dhe mbi aktivitetet e tij në cilësinë e organit ekzekutiv të njësisë së vetëqeverisjes vendore, rëndon detyrimi për raportim.

Për rrjedhojë, edhe kushti i dytë përsa i takon subjektit që duhet ta kryejnë veprimtarinë publike, që duhet raportuar pranë KQZ, plotësohet në rastin konkret.

...Për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023, periudha 4 (katër) mujore, brenda të cilës ekziston detyrimi për raportim i aktiviteteve publike, ka filluar më datë 13 Janar 2023. Ndërkohë që, veprimtaria publike në ambientet e shkollës "George Soros" është realizuar më datë 2 shkurt 2023...

Megjithë këtë detyrim ligjor që buron për institucionin përgjegjës për të raportuar aktivitetin në fjalë, siç rezulton nga provat bashkëlidhur këtij kallëzimi, institucioni nuk ka ndërmarrë asnjë masë për raportimin e këtij aktiviteti në ndërfaqen e krijuar dhe administruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe për rrjedhojë, subjekti përgjegjës duhet sanksionuar ...”

Nëpërmjet shkresës nr. 927 prot. datë 17.2.2023, në vijim të procedurës administrative, filloi hetimi administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtarinë publike të paraportuara në ndërfaqe, me shkresën.

Nëpërmjet shkresës me nr. 683/1 prot. datë 20.2.2023, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 927/1 prot., datë 24.02.2023, jemi informuar nga bashkia Rrogozhinë se:

“Me datë 02.02.2023 Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë ka kryer Inspektimin e punimeve në shkollën 9-vjecare "Xhorxh Sorros". Kjo veprimtari është raportuar në faqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, me datë 28.01.2023, në përputhje me nenin 92/2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" dhe Vendimin Nr.9, datë 24.12.2020 të KQZ-së, neni 4, pika 4.

Gjithashtu ju njoftojmë se prova nr.3 -Screenshot "faqja e raportimit të KQZ" të paraqitur nga ana juaj nuk korrespondon me aktivitetin e sipër përmendur. Në këto kushte Bashkia Rrogozhinë kundërshton kallëzimin e Qendrës "Qëndresa Qytetare", si të pabazuar në fakte dhe prova. Bashkëngjitur edhe postimin në faqen e KQZ-së të aktivitetit..."

Nga verifikimi i të dhënave në ndërfaqen e raportimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, rezultoi se bashkia Rrogozhinë, ka raportuar kryerjen e aktivitetit objekt denoncimi më datë 28.1.2023.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Rrogozhinë, nuk përbën në shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj z. Elton Sula, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Rrogozhinë.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI